



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Ekspert i Zhvillimit Ekonomik - niveli senior (1)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, mbështetur nga Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (RDPA) në kuadër të kryerjes së Studimit fillestar (Baseline Study) për Vlerësimin e Impaktit të Programit 100 Fshatrat, është duke kërkuar shërbimet e një konsulenti individual lokal - Ekspert i Zhvillimit Ekonomik.

Fusha e veprimtarisë: Eksperti i Zhvillimit Ekonomik do të punojë ngushtësisht me Koordinatorin e Projektit në përgatitjen dhe dorëzimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Programit 100 Fshatrat dhe Studimit Fillestar (Baseline Study) mbi Vlerësimin e Ndikimit të Programit. Në bashkëpunim me pjesën tjetër të ekipit, do të angazhohet në interpretimin e rezultateve të anketimeve, mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave dytësore, përgatitjen e raportit të gjetjeve të studimit dhe procese të tjera që kontribuojnë në realizimin e këtij studimi.

Numri i ditëve të punës: 50 ditë pune gjatë periudhës Maj - Nëntor 2022.

Përgjegjësitë kryesore: Eksperti do të jetë përgjegjës për:

Eksperti do të jetë personi përgjegjës kryesor i ngarkuar për:

- përgatitjen dhe rishikimin e metodologjisë, mjeteve dhe instrumenteve që do të përdoren për vlerësimin e impaktit në të dy fazat e realizimit të tij;
- vlerësimin, mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave dytësore të kërkuara për studimin;
- ofrimin e të dhënave statistikore dhe raporteve përmbledhëse sipas detyrave specifike;
- përgatitjen e raportit të gjetjeve të studimit të vlerësimit të impaktit (baseline study);

Përgjegjësitë specifike: Eksperti do të angazhohet specifikisht për sigurimin e realizimit në kohë dhe me cilësi të detyrave të mëposhtme si pjesë e këtij studimi:

- *Detyra 1 - Përcaktimi dhe zhvillimi i metodologjisë së vlerësimit;*
Hartoni metodologjinë, mjetet dhe instrumentet e nevojshme për kryerjen e këtij studimi. Për realizimin e kësaj detyre, eksperti do të bashkëpunojë me Koordinatorin e Projektit dhe pjesën tjetër të ekipit, duke dhënë siguri se metodologjia dhe mjetet e propozuara janë të duhurat dhe do të japin rezultatet e pritshme me objektivitet. Ai është përgjegjës për sigurimin e cilësisë, lëvrimin dhe aplikimin në kohë të metodologjisë, mjeteve dhe instrumenteve të përdorura në këtë vlerësim. Njëkohësisht pas testimit të mjeteve dhe instrumenteve metodologjike, bën rishikimin dhe përmirësimet e nevojshme.
- *Detyra 2 - Anketimi 1: Anketimi i Familjeve;*
Siguron aplikimin e metodologjisë, mjeteve dhe instrumenteve të duhura në anketimin e familjeve.
- *Detyra 3 - Anketimi 2: Anketimi i Biznesit;*
Siguron aplikimin e metodologjisë, mjeteve dhe instrumenteve të duhura në anketimin e biznesit.

- Detyra 4 - Anketimi 3: Anketimi i Turistëve:
Siguron aplikimin e metodologjisë, mjeteve dhe instrumenteve të duhura në anketimin e turistëve.
- Detyra 5 - Fokus grupet:
Në bashkëpunim me Koordinatorin e Projektit siguron cilësinë dhe përmbajtjen tematikave që do të orientojnë diskutimin, raportimin dhe konkluzionet e takimeve dhe reflektimin e tyre në raportin e gjetjeve të studimit. Përcakton numrin dhe lokacionet e zhvillimit të takimeve.
- Detyra 6 - Mbledhja e të dhënave dytësore:
Eksperti është përgjegjësi kryesor për përcaktimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dytësore/statistikore në të gjitha nivelet. Në bashkëpunim me Koordinatorin e Projektit, koordinon me institucionet dhe agjencitë për marrjen e të dhënave që nevojiten për realizimin e këtij studimi.
- Detyra 7 - Përgatitja e Raportit të Gjetjeve të Studimit Fillestar (Baseline Study):
Eksperti është përgjegjësi kryesor për hartimin dhe përgatitjen e Raportit të Gjetjeve të Studimit Fillestar (Baseline Study). Kjo detyrë do të kryhet në koordinim dhe bashkëpunim me ekspertët e tjerë që do të angazhohen në përgatitjen e tij. Garanton cilësinë dhe dorëzimin në kohë të raportit të gjetjeve të studimit.

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara: të paktën 7 vjet përvojë në përgatitjen e metodologjive të vlerësimit, analizimin e të dhënave, menaxhimin dhe kryerjen e sondazheve bazë të zhvillimit, vlerësimet dhe kërkimin në terren, duke përfshirë përvojën e rëndësishme në kryerjen e studimeve në shkallë të gjerë, komplekse, me metoda të përziera dhe prodhimin me cilësi të lartë të materialeve të shkruara.

Eksperti duhet të zotërojë një diplomë master në një fushë të lidhur me ekonominë, ose ekuivalencën e eksperiencave në punë të ngjashme për të paktën 7 vjet. Duhet të demonstrojë njohuri dhe aftësi të mira në operimin me softwareve të lidhur me të dhënat si Microsoft Excel, SPSS, STATA ose ekuivalentet e tyre. Eksperti duhet të ketë aftësi analitike dhe të ketë përvojën e nevojshme në punën në ekip. Trajnimet dhe certifikatat për kryerjen e metodologjive, anketimeve dhe hartimin e raporteve, konsiderohen vlerë e shtuar.

Koordinimi me punëdhënësin, autoritetet qendrore dhe vendore.

Konsulenti do të kontraktohet nga Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (RDPA) dhe do të punojë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të FSHZH-së, për të menaxhuar dhe realizuar detyrën.

Eksperti do të ofrojë përditësime/raporte javore mbi ecurinë e progresit të mbledhjes së të dhënave gjatë kryerjes së tre anketave, duke përfshirë tabelat e përzgjedhura të rezultateve, në shqip dhe në anglisht.

Gjatë përfundimit të detyrave mund të zhvillohen disa procese konsultimi, duke patur parasysh se pjesë e këtyre konsultimeve mund të jenë edhe institucione, agjenci apo subjekte të tjera shtetërore përkatëse të konsideruara si të rëndësishme për këtë studim.

Në nivel lokal, eksperti do të bashkëpunojë ngushtë me autoritetet përkatëse vendore, të cilët janë përfituesit e drejtpërdrejtë të programit.

Kohëzgjatja e Kontratës dhe Termat e Pagesës

Detyra parashikohet të përfundojë brenda **7 (shtatë) muajve**, nga data e nënshkrimit të kontratës. Koha e parashikuar e fillimit të shërbimeve është Maj 2022. Kontrata pritët të përfundojë deri më 30 Nëntor 2022.

Konsulenti do të paguhet individualisht nga programi RDPA, megjithëse ai do t'i raportojë kryesisht FSHZH-së.

Njoftim i rëndësishëm: Duke qënë se për kryerjen e këtij studimi do të angazhohen dhe konsulentë të tjerë që do të mbulojnë pozicione dhe detyra të tjera komplementare të nevojshme për kryerjen e këtij studimi, lejohet angazhimi i konsulentëve individualë që në aktivitetin e tyre të përditshëm mund të jenë pjesë e së njëjtës strukture/kompanie/OJQ.

Aplikimi Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dërgojnë CV, letër interesi dhe përmbledhje të punëve të tjera të ngjashme me këtë kontratë, në adresën e-mail: burimenjerezore@albaniandf.org, jo më vonë se data 15 Prill 2022, ora 16:30.